

KONFERENCA SHKENCORE MBARËKOMBËTARE “NJË KOMB, NJË GJUHË”

Në kuadrin e edicionit XIII të Ditëve të Albanologjisë, veprimtari e përvitshme e Akademisë së Studimeve Albanologjike, në bashkëpunim me Institutin Albanologjik të Prishtinës dhe Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, u mbajt Konferenca shkencore mbarëkombëtare “Një komb, një gjuhë”. Kjo veprimtari shkencore e tri qendrave kryesore albanologjike, që përkon me dy përvjetorë të rëndësishëm për kombin shqiptar: me 110-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë dhe me 50-vjetorin e mbajtjes së Kongresit të Drejtshkrimit, u organizua në tri sesione: sesioni hyrës më 22 nëntor 2022 në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, sesioni i dytë më 23 nëntor 2022 në Institutin Albanologjik të Prishtinës, dhe sesioni i tretë i mbajtur më 25-26 nëntor në Pallatin e Kongreseve në Tiranë. Paralelisht me zhvillimin e punimeve të sesionit të tretë, në hollin e Pallatit të Kongreseve u hap ekspozita “Nga alfabeti në drejtshkrim”, përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Tiranë, në të cilën u ekspozuan dokumente të ndryshme që ilustrjnë momente të rëndësishme të përpjekjeve të mëdha të shqiptarëve për ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës shqipe.

Ky sesion i fundit u çel nga akad. Valter Memisha me fjalën e mirëseardhjes për të pranishmit, në të cilën u falënderuan gjithë pjesëmarrësit nga qendra albanologjike universitare dhe të kërkimit shkencor në Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut e më gjerë, si dhe albanologë nga Gjermania, Greqia e Bullgaria, të cilët u bënë pjesë e kësaj veprimtarie të rëndësishme shkencore për gjuhën shqipe.

Ngjarjet kryesore që lidhen me gjuhën shqipe që prej Kongresit të Manastirit deri në ditët e sotme ishin në qendër të një videoklipi të përgatitur posaçërisht për këtë konferencë.

Në këtë seancë hyrëse përshëndetën emra të njohur të botës akademike shqiptare, si: Rektori i Akademisë së Studimeve Albanologjike, prof. dr. Luan Përzhita; Zëvendësministri i Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit, z. Endrit Hoxha; akad. Jani Thomai; Drejtori i Institutit Albanologjik të Prishtinës, prof. dr. Hysen Matoshi; Drejtori i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve, Shkup, prof. dr. Skënder Asani; Dekani i Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, Universiteti i Tiranës, prof. dr. Sabri Laçi, si dhe Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Shkup, prof. dr. Ylber Sela.

Në veprimtari pati një pjesëmarrje të gjerë të studiuesve të shqipes, të cilët sollën studime e këndvështrime të reja, të dhëna e analiza konkrete rreth përdorimit të gjuhës shqipe në tri diasistemet: diastratik, diafazik dhe diamezik.

Një peshë të veçantë në këtë veprimtari mbarëkombëtare zuri risjellja e ngjarjeve më domethënëse në vite për ruajtjen dhe përparimin e gjuhës shqipe, që zënë fill me Kongresin e Manastirit e vijnë me aktivitete të llojeve të ndryshme në Janinë, Elbasan, Shkodër e Lushnjë, me themelimin e Institutit të Studimeve Shqiptare, me takime e konsulta të njëpasnjëshme në Kosovë, me Kongresin e Drejtshkrimit etj., nën kushtet e rrethanave të caktuara dhe të ndryshme politike që shoqëronin Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë gjatë atyre viteve. Një vend të rëndësishëm në këtë aktivitet të mbajtur për dy ditë në Tiranë patën dhe diskutimet mbi shqipen standarde dhe nevojën për ndryshime, mbi bazën e saj dialektore dhe rëndësinë veçanërisht të gegërishtes, mbi domosdoshmërinë e një politike të re gjuhësore etj.

Punimet e ditës së parë të këtij sesioni u ndoqën nga dy seanca të njëpasnjëshme. Seancën e parë e hapi Drejtori i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Artur Lama, i cili referoi *Shqipja standarde 50 vjet pas Kongresit të Drejtshkrimit*. Më tej vijuan: Xhevat Lloshi, *Komisia Letrare e Shkodrës dhe gjuha standarde*; Emil Lafe, *Prof. Kostaq Cipo vizionar i procesit të formimit të shqipes letrare të përbashkët*; Anila Omari, *Përbërësja e leksikut me burim nga gegërishtja në shqipen e përbashkët letrare*; Rami Memushaj, *“Propozime për drejtshkrimin” – pikënisje për përmirësimin e rregullave dhe detyrë drejtshkrimore e shqipes*; Shezai Rrokaj, *Prirje fjalëformuese të shqipes standarde pas viteve '90*.

Në seancën e dytë pati trajtime me mjaft interes të çështjeve të ndryshme gjuhësore nga: Gjovalin Shkurtaç, *Trysnia e huaj dhe qëndresa e shqipes (Probleme drejtshkrimore dhe morfologjike të emrave të huaj e të huazuar në shqipe)*; Hajri Shehu, *Gjuha shqipe standarde dhe fjalori kombëtar*; Giusepina Turano: *Il ruolo delle scienze albanistiche nella conoscenza della lingua albanese in Italia / Roli i shkencave albanologjike në njohjen e gjuhës shqipe në Itali*; Anila Kananaj, *Rreth alternativave të konstruktive foljore për varietetet e shqipes*; Qemal Murati, *Planifikimi i korpusit të gjuhës letrare shqipe në Maqedoni (1959-1962) dhe reflektimet tona për standardin sot*; Zeqirija Ibrahim, *Perspektiva e gjuhës standarde shqipe në gjysmëshekullin e ardhshëm*; Fadil Graçevci, *Adem Demaçi i dialektit dhe i standardit*; Teuta Toska, *Parimi fonetik i drejtshkrimit të shqipes përballë komunikimit global*; Naim Berisha, *Konsulta Gjuhësore e Prishtinës dhe Kongresi i Drejtshkrimit sipas shtypit të kohës – reflektime të sotme*; Genciana Abazi-Egro, *Lëvrime i shqipes si proces identitar në prag të nacionalizmit*; Shkëlqim Millaku, *Çështje morfosintaksore në Projektin e drejtshkrimit të vitit 1967*; Entela Komnino, *Probleme e perspektiva të standardit të shqipes nga këndvështrimi mediatik*; Natasha Poroçani, *Dy perspektiva qasjeje ndaj së njëjtës gjuhë në shkollë*;

Manola Kaçi (Myrta), *Elbasanishtja letrare në historinë e standardit të shqipes*.

Gjatë ditës së dytë të këtij sesioni punimet u zhvilluan në tri seanca. Në seancën e parë u kumtuan: *Globalizmi dhe gjuha shqipe drejt greminës* nga Edmond Tupja; *Gjuha shqipe për të huaj: 60-vjetori i kursit të parë të shqipes në Universitetin e Sofjes* nga Rusana Hristova-Bejleri,; nga Dhori Qiriazi, *Nga "Iliadhë" e Omirit tek "Iliada" e Homerit (Përthyerje drejtshkrimore të riorientimit kulturor të shqiptarëve)*; nga Bardhyl Demiraj, *Komisia Letrare e Shkodrës në fokusin e Kultusprotektorat-it të Habsburgut*; nga Leonard Dauti, *Zanorja mbështetëse si problem drejtshkrimor dhe interpretimi i alomorfisë së shkaktuar prej saj*; nga Nexhip Mërkuri, *Dukuri dhe probleme në fushën e onomastikës së shqipes*; nga Zamira Shkreli – Erzen Koperaj: *Sesionet shkencore të vitit 1952, pikënisja për krijimin e shqipes standarde*; nga Xheladin Zymberaj, *Bashkëpunimi ndëruniversitar Prishtinë – Tiranë në vitet '70-të të shekullit XX*; nga Basha – Lura Turhani: *Probleme të zotërimit të normave drejtshkrimore të nxënësit e arsimit parauniversitar*; nga Qëndrim Morina, *Gjuha standarde shqipe në fazën e modernizimit*; nga Irda Dervishi (Nesimi), *Turqizmat në veprën "A Historical Albanian-English Dictionary" të S. E. Mann-it përqsasur me fjalorët shpjegues të shqipes*; nga Elvira Çaushti, *Mendime të gjuhëtarëve të ndryshëm mbi Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe*; nga Paula Papa (Shqypi), *Vëzhgime të tipologjive drejtshkrimore në revistën "Kumtari Arsimuer" të vitit 1921*; nga Alma Dema, *Noeshqiptarizma dhe përpjekja për identitet kombëtar mishëruar në gjuhë dhe letra shqipe*.

Në seancën e dytë mbajtën këto kontribute: Tefë Topalli – Orjeta Baja, *Tradita e hartimit dhe e botimit të manualeve drejtshkrimore të shqipes në Shkodër, 1902-1927*; Tomorr Plangarica, *Mbi kompetencën komunikative të përdoruesve të shqipes standarde (qasje studimore, koncepte, probleme)*; Artur Lama, *Rreth përdorimit të gjuhës letrare në Kuvendin e Shqipërisë*; Kujtim Kapllani, *Profesorët A. Kostallari, A. Hadri dhe I. Ajeti – ikona të ligjërimit të përbashkët letrar kombëtar*; Evalda Paci, *Historia e letërsisë së shkruar shqipe në punime tematike me vështrim sistematizues (1950-1985)*; Ibrahim Gashi – Donika Avdulli, *Përparimi i arsimit shqip në Kosovë në frymën e Kushtetutës së vitit 1974*; Aristotel Spiro, *Riformulimi i saktë i parimeve të drejtshkrimit shqip – kusht themelor për modernizimin e tij*; Valter Memisha, *Mbi karakterin kombëtar e popullor të shqipes së sotme*; Enkeleida Kapia – Felicitas Kleber: *Krahasim i sistemit prozodik të shqipes standarde me shqipen e folur një shekull më parë*; Edlira Troplini Abdurahmani, *Për një gjuhë standarde të zhvilluar*; Hysnie Haxhillari – Anylla Saraçi: *Prirje të normës morfonologjike në ligjërimit shqip*; Rrezarta Draçini – Merita Hysa: *Ekonomia gjuhësore dhe prirjet bashkëkohore të shqipes*; Edmond Cane, *Pritshmëri të standardit ndaj të folmeve arbëreshe*; Edona Jahiu, *Rruga dhe domethënia kombëtare e njësimi*

të shqipes: Nga Ëvetari deri te Kongresi; Desela Nuredini, Bashkimi kombëtar – si shqipja ruajti gjurmët dhe kombi identitetin.

Në seancën e fundit u kumtua: nga Mimoza Prikë, *Vendimet e Komisionit Letrar (1916-1918) për shqipen e përbashkët dhe sot*; nga Adelina Çerpja, *Formimet mbiemërore me prapashtesat -të dhe -ët*; nga Kledi Shegani, *Prirje të zhvillimit të shqipes dhe çështje që lidhen me drejtshkrimin*; nga Resul Telhaj, *Prirje në përdorimin e lidhëzës “apo” në gjuhën shqipe*; nga Rezearta Murati, *Jehona e Kongresit të Manastirit në shtypin e kohës*; nga Helena Grillo Mukli, *Roli i shkollës në rritjen e prestigjit të shqipes standarde*; nga Alda Jashari, *Probleme të përdorimit të fjalëve të huaja në komunikimin publik dhe ligjërimin mediatik*; nga Artan Xhaferaj, *Vështrime për drejtshkrimin e ë-së së patheksuar mbështetur në të dhëna statistikore*; nga Dedë Qokaj, *Cikli i kreshnikëve në trevën e Pultit, prurje e fuqishme gjuhësore drejt standardit*; nga Rriolla Agolli, Laura Agolli, Brixhilda Lilka, *Fjalori i gjuhës shqipe (mosha 5-11 vjeç) – ndërthurje e leksikografisë dhe e përvojës pedagogjike*; nga Rezarta Yzo, *Vëzhgime drejtshkrimore në peizazhin gjuhësor të Tiranës*; nga Majlinda Bushaj – Nevila Karajfilaj, *Roli i shkollës në përvetësimin e standardit.*

Në përfundim u zhvillua një seancë në të cilën pati diskutime për disa prej kumtesave të mbajtura. Drejtuesit e saj, akad. Valter Memisha dhe prof. dr. Artur Lama bënë një përmbledhje të kontributeve të sjella në këtë konferencë, duke u përqendruar sidomos në prurjet apo qasjet e reja teorike, të cilat sigurojnë mundësi të reja interpretimi dhe zgjidhjeje për çështje ende të diskutueshme, qoftë në rrafsh teorik, qoftë në atë zbatues. Gjuha shqipe gjendet përballë sfidave të brendshme zhvillimore, por edhe përballë sfidave të globalizimit, prandaj këto kontribute do të shërbejnë si nxitje dhe për ndërmarrjen e punimeve apo të projekteve të tjera për gjuhën shqipe në nivel institucional edhe në këndvështrime të reja teorike gjuhësore.

Adelina Çerpja